



AKT THEMELIMI

i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"BOIKEN" SHPK

Z. Ilir Trebicka, i biri i Polikronit lindur me 25.05.1954 ne Tirane dhe banues ne rrugen "Dora D'istria" P.10, shk1, Ap.12.

Z. Agim Shenediela, i biri i Mustafait, i lindur ne Korce ne 16.02 1956, dhe banues ne rrugen "Ismail Qemali" P.Green Park, Ap65.

Te cilet kane rene dakord qe te krijojne nje Shoqeri me përgjegjësi të kufizuar konform vullnetit te tyre te lire dhe ligjit nr.7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerine Tregtare", ligjit nr. 7667, date 28/1/1993 "Per regjistrimin tregtar" si dhe ligjit nr.7512, date 10/8/1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private dhe privatizimit", si me poshte.

NENI 1

Te themeloje nje shoqeri me përgjegjësi të kufizuar per te ushtruar veprimtari ekonomike e emeruar "BOIKEN" SH.P.K

Kjo Shoqeri tregtare do te kete seline ne Tirane rr "Ismail Qemali" pall "GREEN PARK" Kati i 3 (trete) dhe do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohe 15 (pesembedhete) vjet me te drejte ripërtëritje. Ajo mund te hape filiale brenda dhe jashte vendit.

NENI 2

Sipas legjislacions Shqiptar, Shoqeria "BOIKEN" SH.P.K eshte person juridik Shqiptar dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te ligjit nr.7638, date 19/11/1992 dhe ligjit nr.767, date 28/1/1993. Nga normat e parashikuara ne kete kontrate dhe statutit qe do ti bashkangjitet kesaj kontrate Shoqeria përgjigjet ne marredheniet me te tretet vetem me fondet e veta dhe ortaket përgjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE: se Shoqerise me përgjegjësi të kufizuar "BOIKEN" SH.P.K dote jete:

- Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit dhe inerteve.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit te ndertesave publike e private, te objekteve social-kulturore, te objekteve industriale, te rrugeve e te kanalizimeve.
- Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial duke kryer kete veprimtari per te siguruar fitime sipas parimeve te ekonomise se tregut ne perputhje me legjislacionin.



NENI 4

KAPITALI THEMELOR i Shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e barabarte me 1.000 leke dhe kuotat e sejcilit ortak jane si me poshte:

Ilir Trebicka merr pjese me 50% te kapitalit
Agim Shenediela merr pjese me 50% te kapitalit.

NENI 5

Kapitali themelor i Shoqerise sipas nenit 4 te kesaj kontrate, perfaqeson kapitalin e derdhur nga ortaket te nevojshem per veprimtarine e Shoqerise. Sipas kerkeses se ligjes, Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje bankat e Shtetit Shqiptar ose ne nje bankat e tjera qe jane hapur ose dote happen ne te ardhmen ne Shqiperi te lejuara nga Shteti Shqiptar. Ne librin e llogarise qe dote krijoje Shoqeria tregtare do te shenohet edhe kapitali i derdhur nga cdo ortak. Rritja e kapitalit te ortakeve nuk eshte e kufizuar.

Neni 6

Shoqeria e vazhdon veprimtarine esaj ne baze te regjistrimit si person juridik ne Gjykatën e rrethit te Tiranës, duke emertuar Shoqerine tregtare ne nje nga format e kerkuara nga ligji.

Shoqeria pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaket. Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet, eshte plotesisht i transferueshem per tu depozituar ne nje nga bankat jashta Shqiperise. Fitimi neto ndahet ndermjet ortakeve ne kuotat e vena ne krijimin e kapitalit themeltar te percaktuar ne kete kontrate.

NENI 7

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Ansambleja e ortakeve dhe

Administratori, ku si i tille ky i fundit vepron sipas ligjes per Shoqerine Tregtare.

Administratori eshte caktuar Zoti Agim Shenediela

NENI 8

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacioneve, njohjeve eksperiencës së kembyer dhe realizuar brenda Shqipërisë dhe të marrin të gjitha masat për realizimin e tyre qoftë dhe të pjesshme. Ortakët janë përgjegjës për pasojat e demshme e të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqerite Tregtare.



NENI 9

Zgjidhja e mosmarrveshjeve midis ortakeve do te behet konform normave te konventave nderkombetare per rregullimin e mosmarrveshjeve ne Shoqerite Tregtare ose ne Gjykatën e Rrethit, Tirane, ose ne nje nga Gjykatat nderkombetare.

NENI 10

Dispozitat me te detajuara per Shoqerine Tregtare "BOIKEN" Shpk ,jane percaktuar me permbajtjen ne statutit te saj.

NENI 11

Kjo kontrate perpilohet ne kater kopje nga te cilat njera depozitohet ne zyren e Noterise-Tirane , njera depozitohet ne Gjykatën e Rrethit –Tirane ,njera ne zyren e Tatimeve dhe kopja e katert mbahet me dokumentat zyrtare te Shoqerise .

Kontrata eshte e vlefshme qe nga momenti I nenshkrimt te dy ortakeve.

ORTAKET


Ilir Trebicka

Agim Shenediela

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
No...245...Rep
No...351...Kol

VERTETIM

Sot me daten...21.12.1999... ne Zyren e Noterise, ne rrugen Zhan D' Ark ne Tirane para meje noteres ~~Artemisa Meçaj~~ paraqiten personalisht Ilir Trebicka dhe Agim Shenediela te njohur personalisht prej meje madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se sa me siper eshte akti i themelimit e Shoqerise "BOIKEN."I hartuar jashte kesaj zyre me deshiren dhe vullnetin e tyre te plote dhe e nenshkruar rregullisht para meje.



STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ BOIKEN “ SH.P.K



Shoqëria Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar “BOIKEN” sh.p.k themelohet në përputhje me ligjin nr 7638 dt 19.11.1992 “Per shoqërite Tregëtare”.

Kjo shoqëri krijohet nga ortakët:

1. Ilir Trebicka
2. Agim Shenediela

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike e organizimin e kesaj Shoqërie ne përputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “Per shoqërite Tregëtare”, dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 “Per Regjistrimin Tregëtar” palet rane dakord te hartojne kete Statut, i cili eshte perpiluar me kerkesat e ligjes “Per Shoqërite Tregëtare me përgjegjësi te kufizuar” si me poshte:

KAPITULLI I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

(forma, emertimi, objekti, selia, kohezgjatja)

NENI 1

Ndermjet Ortakeve te lartepemendur pjesemarres ne kontraten e themelimit eshte krijuar nje Shoqëri Tregëtare me përgjegjësi te kufizuar

NENI 2

Emertimi I shoqërise Tregëtare me përgjegjësi te kufizuar eshte “BOIKEN” sh.p.k dhe ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Prodhim dhe tregëtim te materialeve te ndertimit dhe inerteve .
- Veprimtari ne fushen e ndertimit te ndertesave publike e private,te objekteve socialkulturore, te objekteve industriale, te rrugeve ,te kanalizimeve.
- Tregëtm me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial duke kryer veprimtari per te siguruar fitime sipas parimeve te ekonomise se tregut ne përputhje me legjislacionin.

Selia e shoqërise tregtare me përgjegjësi te kufizuar “BOIKEN” sh.p.k do te jete ne Tirane me adrese Rr.Ismail Qemali ,Pall Green Park,kati I trete.Ajo mund te hape filiale brenda dhe jashte vendit.

Kohezgjatja e shoqërise eshte parashikuar per nje periudhe kohore 15 vjet me te drejte ripërteritje.

Kapitali themelor i Shoqërise Tregëtare eshte 100.000 leke.



NENI 3

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese me nje vlefte per secilen pjese me 1.000 leke te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100 krejtesisht te shlyeshme.

Percaktimi i kontributit te secilit ortak eshte :

1. Ilir Trebicka 50.000 lek baraz me 50%
2. Agim Shenediela 50.000 lek baraz me 50%

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja ortaket kane te drejten e pronesise dhe te perpasise mbi pronen proporcionalisht me pjeset e vena ne krijimin e kapitalit themeltar.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj.

Zmadhimi dhe zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga Asambleja e Ortakeve ku marin pjese te dy ortaket e Shoqerise ose te perfaqesuar nga nje person tjeter i autorizuar prej tyre.

Pjeset e kapitalit themeltar transformohen lirshem midis ortakeve si per arsye trashegimie ose te ndarjes se pasurise ndermjet bashkeshorteve dhe ndermjet paraardhese dhe pasardheseve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen tek te tretet vetem pas miratimit te ortakeve te mbetur por jo me kushte me te favorshme nga ato qe kane ofruar ortaket e tjere.

KAITULLI I DYTE.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 4


Organi vendimor i shoqerise eshte ASAMBLEJA E ORTAKEVE. Cdo ortak merr pjese ne mbledhjet e vendimet e ASAMBLESE dhe disponon nje numur votash te barabarte me pjeset e Kapitalit te tij themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje mandat mbrojtës qe te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjete te kapitalit te tij themeltar.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga secili ortak ,nga administratori, nga ekspertet kontabel ose nga likuiduesit.

Sipas rendesise se vendimeve ,mbledhjet e Asamblese mund te jene te zakonshme dhe te jashtezakonshme.Mbledhja e zakonshme ,me shumice votash absolute vendos per ceshtje te tilla si:emerimi ose shkarkimi i administratoreve nga jashte, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe te kontrollit, miratimi i llogarive ,ndarja e fitimit etj.

Mbledhja e jashtezakonshme vendos me unanimitet per ceshtje te tilla si :ndryshimet ne statut,zvogelimi i kapitalit fillestar, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet,



zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një nga format e parashikuara nga ligja.
Asambleja në mbledhjen e parë të zakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm të dy ortaket të cilët vendimet i marrin në bazë të pjesëve të kapitalit themeltar.

NENI 5

Mbledhja e zakonshme thirret çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimeve ekonomike të Shoqërisë.
Thirrja e Asamblesë bëhet me leter të rekomanduar që u dërgohet ortakeve 15 ditë përpara mbledhjes ku caktohet vendi dhe rendi i ditës.

NENI 6

Shoqëria administratohet nga një ADMINISTRATOR i cili është Agim Shenediela. Në marrëdhënjet me të tretet, administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, që janë në përputhje me objektin Shoqërisë me përjashtim të atyre që janë në kompetencë të Asamblesë së Ortakeve që u jep ky statut dhe legjislacioni në fuqi.



Mbledhja e Asamblesë së Ortakeve cakton vecmas kompetencat dhe detyrat e administratorit
Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj Shoqërisë apo të treta për shkelje të ligjeve, për shkelje në statut apo për fajë të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

NENI 7

Kontrulli i Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhjeje. Ai caktohet nga mbledhja e Asamblesë së Ortakeve që përfaqësojnë pjesë të barabarta në kapitalin themeltar.
Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se verëhen gabime në punën e tij gjë që bën të pamundur kryerjen e detyrës.

NENI 8

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregëtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këto qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin për një afat jo më shumë se periudha një vjeçare.
Paga e punës nuk është e kufizuar, por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e percaktuar me vendime të posaçme të Qeverisë.





KAPITULLI I TRETE

MARREDHENIET –EKONOMIKE FINANCIARE

NENI 9

Viti financiar fillon ne daten 1 Janar dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor te cdo viti, perjshtim behet vetem per vitin e pare te veprimtarise.

1. Llogarite vjetore, inventar, raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohet nga Asambleja e Ortakeve.
2. Miratimi i bilancave dhe i dokumentacionit mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

NENI 10

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit, Asambleja e Ortakeve percakotn pjesen qe i takon secilit ortak ne formen e dividendeve mbi fitimin.

Fitimi qe do t'u ndahet ortakeve ne propocion me pjeset qe permbajne kapitalin themeltar perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumate e lena menjane per forndin rezerve te domosdoshem (jo me pak se 1/20 e fitimit te cdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 te kapitalit themeltar) si dhe te jene zbritur ose t'i jene shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartuara nga vitet e meparshme.

NENI 11

1. llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi dhe jane te shprehura ne Lek ose ne valute te huaj.
Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore e nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshetet ne aktivitetin e pasivin qe detyrimisht, do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

NENI 12

Shoqeria Tregtare me qellim qe te bejne sa me te lehte dhe me te shpejte pagesat me te tretet do te hape nje llogari bankare ne nje nga Bankat qe jane te njohura nga Shteti Shqiptar m vendase ose te huaja.



KAPITULLI I KATERT

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUIDIMI

NENI 13

Me mbarimin e afatit të percaktuar në kontratën e themelimit, zgjatja e tij bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakeve falimenton, bëhet e paaftë ose vdes.

Ajo priset kur mbaron afati i percaktuar dhe ortakët nuk kanë rënë dakort, për të bërë reperteritjen e këtij afati.

Shoqëria mund të shpërdorohet në një nga format e percaktuara nga ligja dhe në formën e kërkuar nga ligji.

NENI 14

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likuidimit që në mëntin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakeve emeron një likuidues i cili paraqet raportin e likuidimit, gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likuidimit dhe afatit në nevojshëm për perfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likuidimit, Asambleja vendos me shumicë votash mbi bilancin perfundimtar mbi aktin dhe rregullsinë e likuidimit, mbi mbylljen e procesit të likuidimit të Shoqërisë.

Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themelor të secilit ortak, likuidimi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet tyre, proporcionalisht me pjesët që zoterojnë në këto kapital.

NENI 15

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit gjatë ekzistencës së Shoqërisë gjatë kryerjes së veprimtarisë ashtu dhe në procesin e likuidimit ndërmjet ortakeve në qoftë se ato nuk do të zgjidhen me mirëkuptim do t'i drejtohen për gjykim Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

NENI 16

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje, njera prej te cilave depozitohet ne Zyren e Noterise Tirane, njera ne Gjykatën e Rrethit te Tiranës, njera ne zyren e Tatimeve dhe e katërta mbahet ne dokumentat per krijimin e Shoqerise.

ORTAKET

ILIR TREBICKA

Ilir Trebicka

[Signature]

AGIM SHENEDIELA

Agim Shenediela

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

No...246...Rep

No...352...Kol

VERTETIM

Sot me datën 21.12.1999... ne Zyren e Noterise, ne rrugen Zhan D'Ark ne Tirane para meje noteres Artemisa Meçaj paraqiten personalisht Ilir Trebicka dhe Agim Shenediela te njohur personalisht prej meje madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se sa me siper eshte akti i themelimit e Shoqerise "BOIKEN."I hartuar jashte kesaj zyre me deshiren dhe vullnetin e tyre te plote dhe e nenshkruar rregullisht para meje.

